




Plani Zhvillimor Urban Fushë Kosova 2021+ REVIDIMI

Draft final
27.12.2011

PJESA TEKSTUALE





Përmbajtja:

Përmbajtja:.....	2
Lista e figurave	3
Lista e tabelave	3
Lista e hartave	3
1. HYRJE.....	4
1.1. Plani Zhvillimor Urban që revidohet	4
1.2. Plani Zhvillimor Urban dhe planet hapësinore sipërore	5
1.3. Zonat me interes të veçantë për Kosovën që përfshijnë qytetin e Fushë Kosovës	7
2. PROFILI I SITUATËS URBANE TË FUSHË KOSOVËS	8
2.1 Kufiri dhe ndarja territoriale	8
2.2 Popullsia	8
2.3 Ambienti i ndërtuar	8
2.4 Infrastruktura	9
3. ANALIZA E SITUATËS URBANE	9
4. PLANI ZHVILLIMOR URBAN	9
4.1 Vizioni, Parimet, Caqet.....	9
4.2 Korniza e Zhvillimit Hapësinor Urban	11
4.3 Strategjitë dhe veprimet për zbatim.....	13
4.4 Dispozitat për Zbatim.....	13
5. PZHU PJESA GRAFIKE.....	22
Literatura, burimet:.....	23



Lista e figurave

- Fig.1. Fushë Kosova dhe Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 +
Fig.2 Plani Zhvillimor Komunal Fushë Kosova 2021+ Vizioni
Fig.3 Plani Zhvillimor Urban i reviduar

Lista e tabelave

- Tab.1 Shtimi i popullsisë në qytetin e Fushë Kosovës

Lista e hartave

- Harta 1. Fushë Kosova – pozita
Harta 2. Destinimi i sipërfaqeve – gjendja ekzistuese
Harta 3. Destinimi i sipërfaqeve – propozimi (2004)
Harta 4. Destinimi i sipërfaqeve – Revidimi 2011
Harta 5. Rrjeti i komunikacionit
Harta 6. Infrastruktura rrugore – gjendja ekzistuese
Harta 7. Infrastruktura rrugore – propozimi
Harta 8. Gjelbrimi propozimi
Harta 9. Institucionet parashkollore - propozimi
Harta 10. Institucionet parashkollore - Revidimi 2011
Harta 11. Institucionet shkollore - propozimi
Harta 12. Institucionet shkollore - Revidimi 2011
Harta 13. Institucionet shëndetësore - propozimi



1. HYRJE

Plani Zhvillimor Urban bënë pjesë në Planet Hapësinore të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës, dhe mbulon territorin e qytetit të Fushë Kosovës.

Plani Zhvillimor Urban i Fushë Kosovës siguron një kornizë afatgjatë të zhvillimit të qytetit, duke përcaktuar shtrirjen hapësinore të zhvillimit urban, qëllimet afatgjate të zhvillimit dhe duke identifikuar prioritetet strategjike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social, mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, infrastrukturë të integruar.

Plani Zhvillimor Urban shërben si udhëzues për Komunën e Fushë Kosovës për alokimin e burimeve financiare dhe njerëzore të saj drejt zhvillimi të qëndrueshëm urban. Ky plan multi-sektorial duhet të drejtojë zhvillimin e qytetit të Fushë Kosovës për së paku 5 vitet e ardhshme duke përcaktuar prioritetet strategjike të zhvillimit komunal.

Plani Zhvillimor Urban bazohet dhe hartohet në pajtueshmëri me “ Ligji për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14” (Ligji nr. 03/L-106), “Ligjin për Planifikim Hapësinor” (Ligji nr. 2003/14), Ligjin për vetëqeverisje lokale (Ligji nr. 03/L-040), në Republikën Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor Urban (Nr.rend.34, nr.prot. 30/03).

Me komisionim dhe udhëheqje të Drejtorisë së Urbanizmit në Fushë Kosovë, Plani Zhvillimor Urban është hartuar në vitin 2004 nga studioja Urbanplus.

Me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe kalimit të afatit ligjor pesëvjeçar, bazuar edhe nga dinamika e zhvillimeve në terren është parashikuar të bëhet revidimi i këtij plani, i cili rezulton me Planin e ri Zhvillimor Urban.

1.1. Plani Zhvillimor Urban që revidohet

Plani Zhvillimor Urban i hartuar më 2004 revidohet dhe së bashku me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në këtë revidim përben Planin e ri Zhvillimor Urban të qytetit të Fushë Kosovës.

Dokumentacioni i Planit Zhvillimor Urban i parashtruar për revidim është marrë nga KK Fushë Kosovë, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm si dhe nga kompania hartuese e këtij plani. Dokumentacioni i Planit Zhvillimor Urban i parashtruar për revidim përbëhet nga:

1. Profili i situatës urbane të Fushë Kosovës
2. Analiza e situatës urbane
3. Plani Zhvillimor Urban
4. PZHU Pjesa grafike



1.2. Plani Zhvillimor Urban dhe planet hapësinore sipërore

Plani Hapësinor i Kosovës

Fushë Kosova, në Planin Hapësinor të Kosovës është vendosur në Hapësirën e Kaltër – Porti i Kosovës, së bashku me Prishtinën, Podujevën, Obiliqin, Lypjanin, Drenasin dhe Shtimen. Vizioni për Hapësirën e Kaltër është:

Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrenë me njëra tjetrën e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.




Fig 1 Fushë Kosova dhe Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 +

Në qendër të zonës së kaltër, parashihet TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurrriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare.

Plani Zhvillimor Komunal Fushë Kosova 2021+

Plani Zhvillimor Komunal Fushë Kosova 2021+ e parasheh qytetin si pjese e brezit të biznesit i cili shtrihet përgjatë rrugës regionale M9. Kjo përkon edhe me PHK dhe Trekëndëshin e Zhvillimit Ekonomik. Rekomandimet e Plani Zhvillimor Komunal Fushë Kosova 2021+ për qytetin janë:

- Ambulanta dhe spitali i qytetit
- Qerdhet të reja
- Shkollë e re në Nakër



- Qendër ditore
- Qendër rekreacioni
- Strehimore
- Zona industriale




Fig 2 Plani Zhvillimor Komunal Fushë Kosova 2021+ Vizioni

Caqet e përcaktuara për zhvillim komunal në PZhK Fushë Kosova 2021+ përfshijnë edhe territorin e qytetit të Fushë Kosovës dhe vlejnjë:

Zhvillimi Ekonomik

Caku 1 – Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore, shtimi i prodhimit agrar, ngritja e agrobizneseve dhe impianteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore

Caku 2 – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, konsolidimi i brezit të bizneseve përgjatë rrugës M9

Caku 3 – Konsolidimi i turizmit në komunë, funksionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik në perëndim të komunës, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore si dhe promovimi i turizmit në këto dy fusha

Zhvillimi Social

Caku 4 – Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbimet tjera publike / komunale

Caku 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese



Zhvillimi Infrastruktural

Caku 6 – Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor

Caku 7 – Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën, me fokus të veçantë në vijën Aeroport - Fushë Kosovë – Prishtinë

Caku 8 – Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit

Caku 9 – Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit

Caku 10 – Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të telefonisë e internetit

Zhvillimi Mjedisor

Caku 11 – Mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore

Caku 12 – Parandalimi i ndotjes nga ndotësit lokal dhe fqinj, në koordinim me MMPH dhe komunat fqinje.

Caku 13 – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

1.3. Zonat me interes të veçantë për Kosovën që përfshijnë qytetin e Fushë Kosovës

Qyteti i Fushë Kosovës përfshihet në dy zona të identifikuara si Zona me Interes të Veçantë për Kosovën me Planin Hapësinor të Kosovës:

- Zona e mihjes sipërfaqësore të linjitit dhe prodhimit të energjisë;
- Zona e veprimit të koordinuar (Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës – TZHEK);

Në këto zona duhet të vendoset regjim i caktuar i zhvillimit.

Poashtu në qytetin e Fushë Kosovës shtrihet edhe Në qytetin e Fushë Kosovës nuk ka Zona e Veçanta të një pjesë e deponisë së hirit nga termoelektranat në Obiliq zonë në të cilën duhet të rigjenerohet mjedisi i degraduar, rekomandim ky edhe i Planit Hapësinor të Kosovës.

Mbrojtura të përcaktuar me Ligjin përkatës dhe planin e Ahtisarit.



2. PROFILI I SITUATËS URBANE TË FUSHË KOSOVËS

Para se të bëhet revidimi i Planit Zhvillimor Urban duhet të prezentohen ndryshimet në gjendjen ekzistuese të qytetit të Fushë Kosovës nga ajo që është regjistruar në Profilin e situatës urbane të Fushë Kosovës më 2004. Ndryshimet kryesore në gjendjen ekzistuese të qytetit në vitin 2011 përbëjnë:

- Kufiri dhe ndarja territoriale
- Popullsia
- Ambienti i ndërtuar
- Infrastruktura

2.1 Kufiri dhe ndarja territoriale

Në periudhën 2008-2010 në Kosovë është realizuar plani i decentralizimit me ç'rast janë krijuar disa komuna të reja. Me rastin e krijimit të komunës së Graçanicës, nga Fushë Kosova është shkëputur fshati Uglarë, e cila është përfshirë në Planin Zhvillimor Urban që revidohet.

Revidimi i Planit zhvillimor Urban prezenton qytetin e Fushë Kosovës pa zonën e Uglarës, me kufijtë e ri administrativ. Qyteti i Fushë Kosovës tani ka një sipërfaqe prej 1185 ha.

2.2 Popullsia

Edhe popullsia e qytetit, me rastin e shkëputjes së Uglarës nga zona urbane e këtij qyteti në kuadër të procesit të decentralizimit, është zvogëluar. Sipas Censusit të fundit Rekos 2011 qyteti i Fushë Kosovës numëron 17326 banorë. Nëse përfshijmë edhe numrin e banorëve jorezident në qytet atëherë popullsia e përgjithshme e qytetit numëron rreth 21500 banorë.

2.3 Ambienti i ndërtuar

Në qytetin e Fushë Kosovës ka pasur një fluks të madh të ndërtimeve kryesisht objekte të banimit shumëbanesor përgjatë rrugës regjionale M9 por edhe sipër kësaj rruge në zonën veriorlindore të qytetit, ndërkaq banimi individual ka vërshuar pjesën qendrore dhe jugore të qytetit.

Migrimi i madh i banorëve edhe nga komunat tjera në qytetin e Fushë Kosovës, për shkak të afërsisë së këtij qyteti me kryeqendrën Prishtinë, ka ndikuar që të rritet dendësia e banimit në qytet, dhe komuna të ndërmarrë hapat për revidim të Planit Zhvillimor Urban.



2.4 Infrastruktura

Sa i përket infrastrukturës ndryshimi kryesor ka të bëjë me zgjerimin e rrugës regjionale M9 nga kryeqyteti drejt Pejës. Zgjerimi i kësaj rruge brenda qytetit të Fushë Kosovës ka mundësuar një trafik më të lehtë të automjeteve në këtë zonë, mirëpo paraqet vështirësi dhe rrezik për qytetarët që kalojnë rrugën si këmbësorë.

3. ANALIZA E SITUATËS URBANE

Duke pasur parasysh zhvillimet në strukturën urbane të qytetit të Fushë Kosovës pas hartimit të Planit Zhvillimor Urban, migrimin në rritje të banorëve në qytet jo vetëm nga fshatrat përreth por edhe nga vendet tjera si dhe realizimi konkret i disa projekteve ka rezultuar me nevojën për:

- Zgjerim të sipërfaqeve për ndërtim
- Ndryshim etazhiteti të lejuar për ndërtim
- Riprojektim të rrugëve / blloqeve urbanistike
- Rilokim të përmbajtjeve të infrastrukturës sociale

Parametrat e tjerë pak a shumë mbesin të njëjtë përveq atyre të përmëndur në Profilin e situatës urbane, dhe janë përmëndur në Planin Zhvillimor Urban poashtu edhe në Planin Zhvillimor Komunal.

4. PLANI ZHVILLIMOR URBAN

4.1 Vizioni, Parimet, Caqet

Vizioni për zhvillimin urban të qytetit të Fushë Kosovës derivon nga vizioni për Zhvillim Komunal të komunës së Fushë Kosovës dhe plani paraprak (Plani Zhvillimor Urban i vitit 2004).

Fushë Kosova, qytet ekonomikisht i zhvilluar, me administratë moderne komunale, mjedis të pastër, infrastrukturë të zhvilluar, shërbime cilësore shëndetësore publike, popullatë të arsimuar dhe me mjedis atraktiv për jetesë dhe investime. Qendër me bujqësi, tregëti, industri dhe turizëm të zhvilluar mbështetur në afërsinë me kryeqytetin dhe infrastrukturë të zhvilluar të komunikacionit.

4.1.1. Parimet e përgjithshme për zhvillim / mbrojtje;



Parimet e përgjithshme të zhvillimit burojnë nga dokumente të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare të planifikimit dhe zhvillimit hapësinor në pikëpamje lokale poashtu edhe globale:

- Ligji mbi Planifikimin Hapësinor
- Parimet Udhëzuese për zhvillimin e Qëndrueshëm Hapësinor të BE-ESDP
- Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm – Agjenda 21
- Parimet e qeverisjes së mirë urbane – Agjenda e Habitatit

Këto parime sigurojnë një kornizë të gjerë udhëzimesh, të cilat promovojnë një zhvillim të planifikuar, të balansuar, të qëndrueshëm të komunës së Fushë Kosovës dhe mbi të gjitha në hap me kohën në të mirë të banorëve dhe në mbrojtje të ambientit të saj.

4.1.2. Caket zhvillimore afatgjate

Bazuar në kushtet dhe gjendjen aktuale të Komunës së Fushë Kosovës si dhe Vizionin për zhvillimin e kësaj komune në të ardhmen Plani Zhvillimor i Fushë Kosovës parasesh këto caje prioritare për zhvillim të komunës në planin afatgjatë:

Zhvillimi Ekonomik

Caku 1 – Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore, shtimi i prodhimit agrar, ngritja e agrobizneseve dhe impianteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore

Caku 2 – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, konsolidimi i brezit të bizneseve përgjatë rrugës M9

Caku 3 – Konsolidimi i turizmit në komunë, funksionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik në perëndim të komunës, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore si dhe promovimi i turizmit në këto dy fusha

Zhvillimi Social

Caku 4 – Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbimet tjera publike / komunale

Caku 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese

Zhvillimi Infrastrukturor

Caku 6 – Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor

Caku 7 – Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën, me fokus të veçantë në vijën Aeroport - Fushë Kosovë – Prishtinë

Caku 8 – Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit

Caku 9 – Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit

Caku 10 – Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të telefonisë e internetit

Zhvillimi Mjedisor

Caku 11 – Mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore

Caku 12 – Parandalimi i ndotjes nga ndotësit lokal dhe fqinj, në koordinim me MMPH dhe komunat fqinje.



Caku 13 – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

Caqet prioritare të zhvillimit komunal të Fushë Kosovës duhet të përkthehen në projekte të integruara të cilat duhet të menaxhohen nga Komuna dhe me një qasje gjithëpërfshirëse, duke aplikuar investimet e partneritetit publiko-privat duhet të zhvillohen deri në përmbushjen e prioriteteve të parapara me këtë plan.

4.2 Korniza e Zhvillimit Hapësinor Urban

4.2.1 Koncepti i zhvillimit hapësinor urban

Korniza e zhvillimit hapësinor për qytetin e Fushë Kosovës nuk ndryshon nga ajo e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban që revidohet prandaj edhe mbetet në fuqi në vijat dhe përkufizimet e përgjithshme të saj.

Në bazë të kërkesës dhe rekomandimeve nga KK Fushë Kosovë në takim me grupet punuese dhe me Drejtorinë e Urbanizmit si dhe me qytetarë, rezulton se shtrirja e vendbanimit dhe nevoja për kapacitet më të madh përbën pikat kryesore të revidimit. Ndryshimet qenësore sipas këtij revidimi, në kornizën e zhvillimit hapësinor kanë të bëjnë me shtrirjen, përkatësisht zgjerimin e disa zonave me destinim të caktuar në Planin Zhvillimor Urban dhe me ndryshim të etazhitetit të lejuar për disa prej këtyre zonave, përkatësisht ngritje të etazhitetit.

4.2.2 Struktura dhe lokacioni hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm

Korniza e zhvillimit hapësinor urban 2011 – 2021+

Mbetet kryesisht ajo e Planit Zhvillimor Urban nga viti 2004. Ndryshimet me këtë revidim konsistojnë në zgjerimin e tokës urbane kryesisht në pjesën veriore, largimin e zonës Uglarë, si dhe ngritjen e etazhitetit në zonën qendrore të shenuar, shih hartën më poshtë (si dhe shtojca grafike):

- Zgjerim të sipërfaqeve për ndërtim
 - o Zgjerimi vjen si rezultat i kërkesave konkrete për ndërtim dhe shkallës së ndërtimeve ekzistuese në territorin në fjalë.
 - o Sipërfaqja e tokës urbane zgjerohet në pjesën veriore të qytetit deri në kufirin e përcaktuar në hartë në shtojcën grafike.
 - o Destinimi i sipërfaqes së zgjeruar dhe parametrat urbanistikë të ndërtimit aplikohen të njëjtit nga destinimi fqinj (i cili zgjerohet).
- Ndryshim etazhiteti të lejuar për ndërtim
 - o Në pjesën qendrore të qytetit vërehet kërkesa për ngritje të etazhitetit me qëllim të mundësimit të realizimit të blloqeve me parametra më të mirë urbanistik, sipërfaqe më e madhe publike si dhe realizim të përmirësimeve infrastrukturore.
 - o Etazhiteti i lejuar vendoset në P+7 (me kushte të veqanta, max P+10).
- Riprojektim të rrugëve / blloqeve urbanistike
 - o Blloqet urbanistike dhe rrugët janë rimodeluar në disa pjesë duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe aplikueshmërinë e tyre praktike në terren.
- Rilokim të përmbajtjeve të infrastrukturës sociale



- o Disa përmbajtje infrastrukturore si psh. Shkolla në Nakër dhe qerdhja në qendër të qytetit janë lëvizur lehtësisht për shkakë praktike të realizimit të tyre. Pozita e re është evidentuar në këtë Revidim të Planit Zhvillimor Urban

DESTINIMI I SIPërFAQEVE - PROPOZIMI

P=1:10000




Figura 3 Plani Zhvillimor Urban i reviduar

Popullsia

Parashikimi për rritjen e popullsisë në dhjetë vitet e ardhshme:

Tab.1 Shtimi i popullsisë në qytetin e Fushë Kosovës

Nk	Numri i parashikuar i popullsisë në komunë	-
No	Numri i tanishëm i popullsisë në komunë	21500 *
P	Shkalla e shtimit vjetor të popullsisë	1.6
n	Numri i viteve të parashikuara	10
	$Nk = No (1 + P/100)n$	
	Nk = 25199	

Korniza zhvillimore me Revidim Planin Zhvillimor Urban parasheh hapësirë të mjaftueshme për të gjithë banorët e Fushë Kosovës në të ardhmen edhe me gjatë së në këtë dhjetë vjet.



Zhvillimi social

Qëndrojnë planifikimet e Planit Zhvillimor Komunal si dhe ato të Planit Zhvillimor Urban. Revidimi parasheh rilokimin e disa përmbajtjeve të infrastrukturës sociale duke pasur parasysh realizueshmërinë teknike dhe praktike të tyre, pa dëmtuar rrezembulueshmërinë e kërkuar me standardet e planifikimit urbanistik.

Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik planifikohet të ngritet në kursin e propozar me të dy planet zhvillimore, Urban dhe Komunal. Zgjerimi i sipërfaqes për ndërtim dhe ngritja e etazhitetit parashikohet të ofrojë edhe ngritje të numrit të vendeve të punës dhe të zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Zhvillimi infrastrukturor

Zhvillimi infrastrukturor pëson ndryshime të vogla.

Sa i përket komunikacionit rrugor, Revidimi i Planit Zhvillimor Urban parasheh që:

- Rruga regjionale M9 e ndërtuar në profil me gjashtë korsi - sipas rekomandimeve edhe të Planit Zhvillimor Komunal duhet të trajtohet me qëllim të qetësimit të trafikut të automjeteve në këtë rrugë si dhe ngritjes së sigurisë së këmbësorëve gjatë kalimit të saj, me aplikimin e elementeve të ndryshme të sigurisë dhe nënkalimeve / mbikalimeve eventuale.
- Rrugët tjera riprojektohen me qëllim të realizueshmërisë praktike të tyre.

Infrastruktura teknike e paraparë me kapacitetet përkatëse për shërbim në qytet është e mjaftueshme dhe duhet të punohet sipas rekomandimeve të Planit Zhvillimor Komunal.

Mjedisi

Qyteti i Fushë Kosovës duhet të mbrohet nga ndotja, dhe në nivel komunal konform rekomandimeve të Planit Zhvillimor Komunal të merr masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga të gjitha llojet e ndotjes.

Duhet të rilokohet deponia ekzistuese e hirit dhe ajo të riaktualizohet si tokë bujqësore ose për qëllime tjera. Duhet të krijohet sistemi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal.

4.3 Strategjitë dhe veprimet për zbatim

Konform caqeve zhvillimore afatgjate, strategjitë dhe veprimet për zbatim aplikohen ato të prezentuara në Planin Zhvillimor Komunal si dhe Planin Zhvillimor Urban që i nënshtrohet këtij revidimi.

4.4 Dispozitat për Zbatim

4.4.1 Udhëzime mbi çështjet e interpretimit të Planit zhvillimor komunal gjatë hartimit të planeve rregulluese dhe planeve tjera

PZHU bazohet në PZHK dhe duhet të jetë në përputhje me propozimet e dala nga ai; Vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin e Kosovës të parapara me PZHK si dhe PHK në territorin e qytetit duhet të respektohen;



PZHU do të jete bazë për hartimin e PRrU dhe planeve tjera urbanistike te parapara në qytet. Këto plane nuk guxojnë të çënojnë dispozitat e PZHU.

4.4.2. Kushte të përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në qytet.

4.4.2.1 Kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e qytetit;

Në qytetin e Fushë Kosovës, plani përcakton këto destinime të sipërfaqeve:

- Banim individual
- Banim me përdhesë aktive
- Banim shumëbanesor (kolektiv)
- Banim shumëbanesor (kolektiv) me përdhesë aktive
- Qendra
- Park biznesi
- Park industrial
- Tregti
- Park dhe sport
- Rekreim
- Gjelbrim mbrojtës
- Zonë e rezervuar urbane
- Tokë punuese
- Varreza të vjetra
- Varreza të qytetit

4.4.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës:

PZHU përmes kornizës së zhvillimit hapësinor përcakton kushtet dhe masat për rregullimin e sipërfaqeve të destinuara: kushtet për rregullimin e qytetit dhe zonës ndërtimore, tokës bujqësore, zonës ekonomike dhe asaj industriale, pyjeve, hapësirave publike, infrastrukturës fizike dhe sociale, hapësirave për sport e rekreacion, hapësirave me rrezikshmëri etj. Në përgjithësi, kushtet për rregullimin e hapësirës bëhen sipas rregullave të përcaktuara nga korniza e zhvillimit hapësinor të Planit, si dhe rregullave të veçanta të përcaktuara me ligje përkatëse dhe ato të përcaktuara me aktet ligjore të planifikimit (UA për kushtet e lokacionit, dhënien e pëlqimi urbanistik dhe lejes urbanistike) me të cilat rregullohen kushtet e lokacionit të objekteve ndërtimore.

a. Ndërtesat me rëndësi për Kosovën;

Në qytet nuk ka ndërtesa me rëndësi të tillë.

b. Zonat ndërtimore;

Zhvillimi i ndërtimeve duhet të zë vend në sipërfaqet e destinuara për këtë qëllim, ku vetëm zhvillimi dhe ndërtimi plotësues duhet lejuar. Dendësimi i ndërtimit dhe metodat e ndërtimit për shfrytëzim më racional të tokës, duhet të jenë parim kryesor për zhvillimin e ardhshëm. Definicioni përkatës i veçorive dhe karakterit të ndërtesave në zonat kufizuese me peizazh me vlerë, duhet përcaktuar me planet rregulluese urbane. Planet rregulluese urbane si instrument i planifikimit, duhet të shfrytëzohen po ashtu edhe për të arritur harmoninë e ansambleve ndërtimore me rrethinën.



Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim (rryma, sistemi i kanalizimit, ai i ujit). Zhvillimi i infrastrukturës duhet ofruar gradualisht, bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës. Alternativat tjera si partneriteti publik-privat ose skemat private të financimit, duhet dakorduar me komunën. Pronari i ndërtesës duhet të paguajë taksat për infrastrukturë, ndërsa mënyra e shpërndarjes duhet të elaborohet.

c. Strukturat e ndërtuara jashtë zonës ndërtimore;

Për zonat e përcaktuara në Planin Zhvillimor Urban si të lira nga cilido lloj i zhvillimit dhe të mbrojtura nga ndërtimi duhet garantuar:

- a) Mbrojtjen e zonave për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë dhe pylltarisë
- b) Zonat me vlera të veçanta ekologjike
- c) Mbrojtjen e peizazhit natyror dhe lokacioneve të trashëgimisë, dhe po ashtu zonat e lidhura natyrore për rekreacion. (duke mos kundërshtuar zhvillimin e vendbanimit)

Jashtë zonës ndërtimore do të lejohen vetëm këto ndërtesa: (Ligji për Planifikim Hapësinor)

- a) Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
- b) Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet e dëmshme – eksploziv etj;
- c) Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
- d) Infrastruktura;
- e) Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar;
- f) Rekreacion dhe turizëm rural

4.4.2.3. Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike;

Në zonat e përcaktuara për biznes dhe industri, do të lejohet vetëm ndërtimi i përmbajtjeve të pastra për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depot, shërbimet dhe përmbajtjet tregtare të cilat nuk kanë ndikim negativ në mjedis.

Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial, mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve, vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit dhe ujit, zhurma).

Bizneset industriale dhe komerciale me ndotje të shprehur nuk do të lejohen fare.

Zgjerimi i zonave ekzistuese të industrisë dhe biznesit, do të lejohet vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për t'u zgjeruar.

Parqet e reja të biznesit duhet të dëshmojnë furnizim energjetik të vet-qëndrueshëm, me prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme nëse ato gjenden në afërsi të potencialit të lartë për energji të ripërtërishme.

Komuna do të lejojë ndërtimin e infrastrukturës, që përkrahë atraksionet turistike dhe aktivitetet e rekreacionit, të cilat nuk kanë asnjë ndikim negativ në mjedis – shtigjet për ecje dhe çiklizëm, pikat e vrotimit, bujtinat, etj.

4.4.2.4. Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike;

Plani Zhvillimor Urban duhet të alokojë tokë rezervë për kërkesa të veçanta (banimi për të moshuarit, institucionet për persona me kërkesa specifike, jetimore etj.), si dhe për zgjerimin



e zonave të aktivitetit publik në përputhje me funksionin e vendbanimit – qendra kryesore, nën qendra, qendër lokale dhe fshat.

Komuna duhet të alokojë hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore. Ato duhen rregulluar me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme me transport publik. Ngastrat e alokuara për këtë ndërtim, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Institucionet parashkollore 20 - 40 m²/fëmijë
- b) Shkollat fillore 20 - 50 m²/fëmijë

Komuna mund të alokojë një ngastër të përbashkët për ndërtimin e përmbajtjeve siç janë: edukimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit. Kjo posaçërisht është e rëndësishme për sub-qendrat dhe qendrat lokale.

Zonat e destinuar për sport dhe rekreacion duhet të jenë të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane për blerjen dhe marrjen me qira të pajisjeve sportive. Maksimumi i indeksit të shputës nuk guxon të kalojë 10% të sipërfaqes së ngastrës.

4.4.2.5. Kushtet për vendosjen e koridoreve apo traseve, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës;

Duhet të hartohet koncepti detaj i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik, këmbëtorët dhe çiklistët) për komunën e Fushë Kosovës.

Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrësia), duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.

Qasje direkte për zhvillim në rrugët kryesore me kufizim të shpejtësisë me më shumë se 60 Km/h nuk do të lejohet.

Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për rrugët kryesore dhe ato rajonale, kështu që rregulloret dhe standardet teknike meritore janë dhënë nga Ministria.

Në komunën e Fushë Kosovës, rrugët kryesore lokale, rrugët lokale dhe rrugët e tjera duhet të dimensionohen në mënyrë që të mund të lejojnë rrjedhë të sigurt të trafikut për të gjitha automjetet në çfarëdo kushte atmosferike. Shtigjet e trafikut duhet të respektojnë rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjëra së paku 3.0m'. Aty ku ka probleme dhe mund të paraqiten barrierat fizike vështirë të kalueshme, shtigjet mund të ngushtohen.

Nëse pozita financiare e komunës nuk mund të sigurojë zbatimin e rrugëve me hapësira të veçanta për këmbëtorë - në zonat e banimit, rekomandohet që rruga të përfshijë shtigjet për këmbëtorë.

Rruga për qasje në ngastrat për ndërtim duhet të jetë minimum 3.0 m' e gjerë dhe maksimum 60.0 m' e gjatë.

Të gjitha udhëkryqet në nivelin e terrenit, duhet të sigurojnë pamje prej të gjitha drejtimeve.



Shtigjet për çiklizëm të një drejtimi, nëse janë të ndara, duhet të jenë 0,8m' të gjëra.

Nëse hapësirat për çiklizëm janë të ndara, atëherë shtegu i gjelbër duhet të jetë 0,35m'.

Në zonat për parkim që shërbejnë për transportin publik, shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet të jetë 2.0 m' i gjerë.

Standardet për parkim janë si në vijim:

- a) Shtëpi banimi për një familje (1VP/shtëpi) në ngastër;
- b) Banimi shumë familjar (1VP/1 banesë, në ngastër mbi tokë apo në garazh)
- c) Zyre: 1VP në 75 m² bttto zone; (12 VP/1000 m² bttto)
- d) Dyqane: 1 VP në 50 m² bttto zone; (20 VP/1000 m² bttto)
- e) Qendër tregtare: 1 VP në 40 m² bttto zone; (25 VP/1000 m² bttto)
- f) Industri dhe depo: 1 VP / 5 të punësuar;
- g) Shërbime 1 VP / 3 të punësuar;
- h) Restorante 1 VP / 1 tavolinë;
- i) Ndërtesa sportive: 1 VP / 20 ulëse;
- j) Shkolla dhe jetimore: 1 VP/ klasa dhe grupe të fëmijëve;
- k) Shërbimet e shëndetësisë: 1 VP / 40 m² brutto . (25 VP/1000 m² bttto)

Në korridorin rrugor të rrugëve kryesore rajonale, është i lejuar ndërtimi i ndërtesave në vijim:

- 1. Pompa të benzinës me dyqane, restorant dhe përmbajtje shërbyese
- 2. Larje dhe shërbime të automjeteve

Këto ndërtesa duhet pasur hapësirën e dedikuar për parkim brenda ngastres.

Gjatë kërimit për leje ndërtimore, miratimi i kushteve speciale për qasje në rrugën magjistrale, duhet të lëshohet nga Drejtoria për Rrugë në Ministrinë për Infrastrukturë.

4.4.2.6. Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike;

Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet ta përgatitë planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbrojë çfarëdo zhvillimi që do të afektojë vlerat e monumenteve, përveç atyre që shërbejnë për mbrojtjen e tyre.

Komuna nuk do të lejojë asnjë zhvillim në tokën kualitative bujqësore, përveç atyre zhvillimeve që shërbejnë për mirëmbajtje të veprimtarisë bujqësore (lavërtaria, pemëtaria etj.).

Të gjitha vlerat natyrore të evidentuara duhet të trajtohen si monumente të mbrojtura të natyrës dhe të mbrohen nga zhvillimet të cilat mund të kenë ndikime negative.

Komuna, së bashku me MMPH-në, duhet të bëjë evidentimin e peizazheve të cilat duhet të mbrohen.



Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të ndërmarrë masa për konsolidim të tokës në zonat e deponieve ilegale.

Komuna duhet të vendosë sistemin për menaxhim të mbeturinave, bazuar në ligjin dhe kompetencat e deleguara, duhet të përmirësojë shërbimet për menaxhim të mbeturinave në Komunën e Fushë Kosovës.

Komuna duhet të hartojë Rregulloren për hapësirat e gjelbra dhe politikën për gjelbërim.

4.4.2.7. Mënyra e trajtimit të hedhurinave;

Komuna do të hartojë konceptin detaj të Menaxhimit të Mbeturinave për zonën urbane të Fushë Kosovës dhe vendbanimeve.

Komuna duhet të krijojë një rrjet funksional të mbledhjes dhe deponimit stacionar të mbeturinave dhe dërgimin e tyre në deponinë rajonale.

Deponia rajonale gjendet në Mirash.

Komuna duhet të ndërtojë një politikë për mbledhjen e materialeve sekondare si dhe për riciklimin e mbeturinave. Komuna e Fushë Kosovës, së bashku me kompaninë publike rajonale për menaxhimin e mbeturinave, duhet të organizojnë ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave.

Komuna do të përmirësojë sistemin të kanalizimit të ujërave të zeza. Ajo do të identifikojë dhe alokojë tokën e përshtatshme për nënstacionin e ujërave të zeza, për trajtimin primar të tyre, duke u bazuar në Strategjinë për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (2004) dhe planet aktuale të kompanisë rajonale.

Hedhja e mbeturinave dhe ujërave të zeza duhet të jetë e qëndrueshme, duke u përqendruar në prodhimin e energjisë ripërtëritëse dhe biomasës në të gjitha zonat e përcaktuara si zona për prodhimin e energjisë ripërtëritëse.

Komuna, së bashku me MMPH, do të hartojë programe dhe politika të vetëdijesimit për trajtimin e ujërave, ndotjes, menaxhimit të mbeturinave dhe çështje të tjera lidhur me mjedisin.

4.4.2.8. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis;

Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna, në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.

Projektet zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve, duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime (përplasje) në mjedis.

Gjatë dhënies së lejeve për objekte zhvillimore ekonomike, në pajtim me rregullat mjedisore, duhet të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis siç janë ndotja e



ajrit dhe zhurma, vibracionet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

4.4.2.8.1 MBROJTJA E UJIT

Burimet e ujit duhet të mbrohen. Gjatë dhënies së lejeve për planifikim, me qëllim të mbrojtjes së ujit nëntokësor, është e nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në vijim:

Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji
Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit
Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza
Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

4.4.2.8.2 MBROJTJA NGA ZHURMA

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga ndotja e zhurmës është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve për motoçikleta dhe vendbanimeve.

4.4.2.8.3 MBROJTJA E AJRIT

Në mënyrë që të mbrohet ajri, është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse.

4.4.2.8.4 MBROJTJA E SHTAZËVE

Të kontrollohet gjuetia, në mënyrë që të mbrohet zhdukja e specieve shtazore.

4.4.2.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social;

Komuna duhet të ofrojë infrastrukturë të nevojshme sociale (edukim, shërbim mjekësor, kulturë, sport) që të shmanget ndikimi negativ social i zhvillimit. Një seri e masave për infrastrukturë duhet të jenë sipas funksionit të vendbanimit (qendra kryesore, qendra lokale).

Dendësia e vendbanimit duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me zhvillimet sociale të vendbanimit.

Komuna do të vlerësojë problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale dhe do të propozojë zgjedhje në ato vende ku hartimi i PRRU është prioritet.

Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsye do të krijohet një bazë e të dhënave, e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata të nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.



4.4.2.10. Masat për zbatimin e planit:

a Detyrimi për hartimin e planit Zhvillimor Urban dhe planeve rregulluese urbane;

Sipas ligjit, plani duhet të rishikohet çdo 5 vite. Plani Zhvillimor Urban duhet të rishikohet në rastin e ndryshimeve thelbësore të kushteve të përgjithshme.

Planet Rregulluese Urbane duhet të hartohen për zonat urbane të Fushë Kosovës sipas nevojës së paraparë nga drejtoria e Urbanizmit si dhe për **VJF**.

Prioritet duhet ti jepet zonave ku problemet hapësinore duhet të adresohen urgjentisht. Kjo përfshin zonat ku kërkohet zhvillimi i brendshëm apo ku qyteti rritet në mënyrë të pakontrolluar dhe të paorganizuar dhe ku rigjenerimi i hapësirave publike është nevojë prioritare.

Lejet ndërtimore për zhvillimet jashtë zonës urbane, por brenda kufijve të paraparë për zgjerim, mund të lëshohen sipas vendimeve me Plan Zhvillimor Komunal.

Për çfarëdo zhvillimi jashtë zonës urbane, më të madhe se 2.0 ha, duhet të hartohen planet rregulluese. Kjo përfshin hapësirat për park të biznesit/industrial, hapësirat për zhvillimin e turizmit dhe hapësirat për sport dhe rekreacion.

Komuna duhet të bëjë Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

b. Aplikimi i masave zhvillimore dhe i masave tjera;

Komuna duhet ta konsiderojë prioritet hartimin e kadastrit të ri modern, si bazë për hartimin Planeve Rregulluese Urbane dhe zhvillimin e mëtutjeshëm.

Kur vendoset për zhvillime, prioritet duhet të kenë zhvillimet që paraqesin densifikim apo zgjerim gradual të zonave ekzistuese për ndërtim.

Planet rregulluese duhet të ofrojnë masa mbrojtëse kundër zjarrit. Këto masa përfshijnë rrjetin për shuarjen e zjarrit në të gjitha pozitat e ndërtesave, qasje të lehtë për kamionët e zjarrfikësve dhe hapësirë për manovrimin e teknologjisë kundër zjarrit sipas rregullave ekzistuese për mbrojtje kundër zjarrit.

c. Rekonstruimi i ndërtesës destinimi i së cilës është në kundërshtim me destinimin e planifikuar.

Ndërtesat ekzistuese në zonat e gjelbra nuk duhet lejuar të zgjerohen përmes rindërtimit.

Problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale do të vlerësohen dhe do të propozohen zgjidhjet sipas direktivave të IPH dhe DPH. Për këtë arsye, duhet të krijohet një bazë e të dhënave, bazuar në një kadastrë modern me informata detaje për çdo ndërtesë.

Rrënimi i ndërtesave, mund të vie në konsiderim në ato raste ku ndërtimet ilegale nuk mund të legalizohen sipas Ligjit mbi ndërtimet ilegale, i cili pritet të aprovohet.



Komuna do të ofrojë një lokacion për ndërtimin e shtëpive të reja për njerëzit që duhen ti lëshojnë shtëpitë e tyre në rast të rrënimave. Gjatë zbatimit të planit, nëse kërkohet, ndërtesat e ndërtuara legale mund të largohen pas shpronësimit apo marrëveshjes me pronarin. Në këtë rast komuna duhet të ofrojë kompensim të mirëfilltë.

4.4.3. Dispozitat lidhur me bashkëpunim;

Komuna informon, bashkëpunon apo/dhe arrin marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Ministrinë dhe Agjencionet përkatëse për projektet e propozuara në PZHK që kërkojnë pjesëmarrjen e këtyre institucioneve

Komuna informon, bashkëpunon apo/dhe lidh marrëveshje bashkëfinancimi me komunat fqinje për projektet me interes të përbashkët. Komuna bashkëpunon me Agjencionin për Zhvillim Regjional në realizimin e projekteve të tilla.

Komuna informon, bashkëpunon dhe arrin marrëveshje partneriteti me ndërmarrjet publike për shërbimet publike në kompetencat e këtyre ndërmarrjeve (çështjet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, menaxhimit të mbeturinave, etj)

Komuna bashkëpunon dhe krijon marrëveshje partneriteti (PPP) me sektorin privat në projektet që të dy palët kanë interes të përbashkët

Komuna krijon marrëdhënie bashkëpunimi ndërkufitar me komunat e shteteve fqinje, për projektet me interes të përbashkët

Komuna bashkëpunon me donatorët e ndryshëm në projektet e parapara me plan realizimi i të cilave mund të ndihmohet nga programet e ndryshme të donatorëve

Komuna përkrah dhe bashkëpunon me OJQ në një sërë projektesh të parapara me plan, e sidomos në ato që kanë të bëjnë me fushata ndërgjegjësimi, promovimin e vlerave të komunës

Komuna gjatë hartimit të planeve tjera që rrjedhin nga PZHU, duhet të sigurojë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e publikut (qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit) qysh në fazat e fillimit dhe gjatë gjithë procesit dhe ndërmerr fushatë informimi ashtu siç është parapa me dispozitat e ligjit për planifikim hapësinor.

4.4.4. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e implementimit;

Komuna themelon njësinë për planifikim e cila do të merret me revidimin, përcjelljen e zbatimit të planit dhe projekteve të dala nga ai, harton raportet vjetore për monitorim dhe vlerësim të planit si dhe jep sugjerimet për ndryshimet eventuale etj

Komuna (njësia për planifikim) harton programin për zbatimin e planit zhvillimor urban.

Veprimet/projektet e propozuara në PZHU janë grupuar në tri faza të zhvillimit:

- faza I: periudhën 2011-2013 ku kryesisht janë të përfshira projektet /veprimet afatshkurta të cilat edhe janë të ndërlidhura me kornizën afatmesme të planifikimit buxhetor komunal



- faza II: periudhën 2012-2016 dhe i përfshin veprimet/projektet afatmesme
- faza III: periudhën 2012-2021+ dhe përfshin veprimet/projektet afatgjata

Të gjitha investimet në komunë që kanë karakter hapësinor duhet të jenë në harmoni me propozimet dhe prioritetet e përcaktuara me Planin zhvillimor komunal

Pas miratimit të planit dhe hyrjes së tij në fuqi, komuna duhet të analizojë planin aktual buxhetor (kornizën buxhetore) dhe gjatë rishikimit të saj, komuna inkorporon projektet e parapara në kornizën buxhetore të rishikuar.

4.4.5. Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm.

Plani Zhvillimor Komunal i Fushë Kosovës ofron një kornizë për zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve në fusha të caktuara si:

- studim fizibiliteti për shfrytëzimin e energjisë alternative.

4.4.6 Dispozitat përfundimtare

Vlefshmëria:

- Ky plan do të jetë vlefshëm deri në vitin 2021. Rishikimi/revidimi i i planit do të bëhet cdo 5 vjet.

Vlerësimi dhe ndryshimet e planit:

- Rishikimi profesional i PZHK-së nënkupton ndryshimet apo plotësimet duhet të bëhet sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar për miratimin e tyre fillestar (*Ligji për Planifikim Hapësinor, 2003/14, neni 20*). Çdo propozim ndryshim, amandamentim apo shfuqizim (abrogimit) i planit duhet të kalojë nëpër procesin e shqyrtimit publik i cili zgjat së paku 15 ditë, dhe jo më shumë se 30 ditë (*Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike 54/2005, neni 5.4*)

5. PZHU PJESA GRAFIKE

PZHU Pjesa grafike – shtojca -



Literatura, burimet:

Literature:

- *Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2011-2014*, KK Fushë Kosovë – Riinvest, dhjetor 2010
- *Plani lokal i veprimt në mjedis –Komuna Fushë Kosovë*, KK Fushë Kosovë - AER,MMPH, EPTISA, 2009
- *Mbrojtja e zonave përreth aerodromeve- Manual udhëzues*, Zyra Rregullatore e Aviacionit Civil, Shtator 2007
- *TP03 Airport Protective Zones – guidance manual*, Civil Aviation Authority, April 2009

Ligjet, rregulloret, udhëzimet administrative:

- Ligji për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14 (Ligji nr. 03/L-106)
- Ligjin për Planifikim Hapsinor (Ligji nr. 2003/14)
- Ligji për Rrugët (Ligji nr. 2003/11)
- Ligji për Hekurudhat e Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L-076)
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Ligji nr. 03/L-025)
- Ligji për tokat bujqësore (Ligji nr. 02/L-26)
- Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural
- Ligjin për vetëqeverisje lokale (Ligji nr. 03/L-040)
- Ligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin
- Ligji për kufijtë administrativ komunal
- Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm
- Ligji për arsimin e lartë
- Ligji për shëndetësinë
- Ligji për energjinë elektrike
- Ligji për ujërat
- Ligji për shërbimet sociale dhe familjare
- Ligji për mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri
- Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera
- Ligji për mbrojtje nga zhurma
- Ligji për trashëgiminë kulturore (Ligji nr. 02/L-88)
- Ligji për ndërtimin (Ligji 2004/15)
- Ligji për turizmin dhe shërbimet turistike
- Udhëzimin Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor Urban.